REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr6572 Prot Maliq, më 02.11.2026

VENDIM
Nr. 125, datë 30.10.2026

"Për miratimin e proces verbalit të datës 28.09.2026 të Këshillit të Bashkisë Maliq"

Në zbatim të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"* i ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 9, pika1, nënpika 1.1, gërma "b", neni 53 pika 8, neni 54 gërma "k" si dhe nenit 88, i Rregullores të fuksionimit të Këshillit Bashkiak Maliq me vendim këshilli nr.24, datë 12.03.2020, Këshilli i Bashkisë Maliq,

VENDOSI:

1.Të miratojë proces verbalin e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Maliq, të datës 28.09.2026 bashkangjitur.

2.Kopja e proceverbalit të miratuar administrohet nga Sekretari i Këshillit sipas procedurave ligjore.

3.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar me 17 vota
Vota Pro 17
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 02.11.2026

KRYETARI I KËSHILLIT
Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 28.09.2026 Prot.61 (gjashtëdhejtëenjë)

Protokoll nr. 61

I mbajtur sot më datë 28.09.2026, në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:

Hapja e mbledhjes (kuorumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3.Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të kaluara datë (20.08.2026) dhe (01.09.2026)
4.Miratimi i mendimit zyrtar të Këshillit Bashkiak Maliq dhe përcjellja e tij pranë Kuvendit të Republikës të Shqipërisë, në kuadër të procesit të rishikimit të ndarjes administrativo-territoriale.Ku bashkia Maliq propozohet të bashkohet me bashkinë Korçë.
5.P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin gusht 2026";
6.P-V "Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë";
7.P-V "Për shqyrtimin e kërkesës për rishikimin e strukturës dhe bonitetit të tokës për pasuritë në pronësi të shoqërisë *"TOPTANI CSE";*
8.P-V "Për miratimin e dhënies në përdorim të përkohëshëm të disa pronave të paluajtshme publike në pronësi/përdorim të Bashkisë Maliq, subjektet *"Fastnet Albania"* sh.p.k, me qëllim zhvillimin e projketit "*Për ndërtimin e rrejtit inxhinerik telefonik me fibër optike Gpon dhe Epon"*;
9.P-V "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB-në nr.2.datë, 08.01.2026 "Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të adminstratës së Bashkisë Maliq dhe strukturave të tjera për vitin 2026"; i ndryshuar.
10.Informacion për Raportin e II-të të Monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e dytë të vitit 2026";
11.Diskutime të tjera.

Këshilltarë të pranishëm në sallë: Ornildi Demollari; Pranvera Begolli; Petrit Kupe; Dritan Çami; Idlir Limllari; Marinathi Avrami; Selami Muço; Danjela Ibrahim; Fevri Sherifi; Krisitna Malelli; Aramando Dautllari; Plator Çollaku; Floreta Zaçe; Yllson Ibrahimllari; Neresida Shindo;

Lulëzim Hoxhaj; Faslli Zholi; Server Xhuti; Eglantina Balli; Almir Elezi; Marjeta Xhelollari; 22(njëzetëedy) këshilltarë.

Mungesa: Eriseld Jonusllari; Xhuana Hoxhallari; Klea Baçi; Dalina Krekas; Rovena Terolli; Enida Avdolli; Gentiana Drabo; Albina Xhejo; Ilia Xhuti; Andonaq Risto; 10 (dhjetë).

Të pranishëm nga Administrata: Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu; Drejtore e Financës dhe Buxhetit; znj.Almira Muka ; Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve;z.Johand Sula; Drejtore e Kulturës; znj.Dhora Shkembi; Përgjegjës i Sektorit të Bujëqsisë;z.Aurel Zenunllari;Drejtore e Shërbimit Social;znj.Ermanda Petriti;

Ornildi Demollari:Mirëdita të gjithëve. Të nderuar kolegë këshilltarë, të nderuar pjesëmarrës. Kjo është mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë Maliqit, mbledhja për muajin shtator, po. Bëjmë një verifikim të korumit si fillim, përpara se të vijojmë. Dhe, me sa shoh, korumi realizohet pasi janë 18 këshilltarë në sallë, kështu që mund të vijojmë me mbledhjen. Dhe ju ftoj të miratojmë rendin e ditës. Kush është dakord me rendin e ditës? 21 vota pro.
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet rendi i ditës. Më lejoni t'ju kujtoj konfliktin e interesit: nëse ndonjëri nga kolegët ka konflikt interesi me pikat e rendit të ditës, është mirë që në atë pikë të mos përfshihet as në diskutim, as në votim. Faleminderit. Kalojmë tek pika 3. Ju ftoj të miratojmë procesverbalin e mbledhjes së datës 20 gusht 2026. Kush është dakord me procesverbalin e mbledhjes? 21 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka. Miratohet. Faleminderit. Ju ftoj të miratojmë procesverbalin e mbledhjes së datës 1 shtator. Kush është dakord me procesverbalin? 21 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka. Miratohet edhe kjo. Faleminderit. Tani kalojmë tek pika 4 e rendit të ditës, që është miratimi i procesverbalit... eh, më falni, miratimi i mendimit zyrtar të Këshillit Bashkiak Maliq dhe përcjellja e tij pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të procesit të rishikimit të ndarjes administrativo-territoriale, ku Bashkia Maliq propozohet të bashkohet me Bashkinë e Korçës. Përpara se të kalojmë në diskutime, dua t'ia jap fjalën komisionit përkatës për raportin e mbledhjes së komisionit.

Pranevera Begolli:Përshëndetje kryetar, përshëndetje të nderuar kolegë, përshëndetje qytetarë që merrni pjesë. Aktualisht, duke parë të gjitha materialet që na janë paraqitur në lidhje me reformën territoriale për bashkimin e Bashkisë Maliq me qytetin e Korçës, po ju bëjmë me dije që komisioni i mbledhur sot, më datën 28.09, ora 09:00, ka vendosur duke u bazuar mbi disa të dhëna. Aktualisht, nëpërpara kemi një raport përmbledhës mbi konsultimet publike që i duhet t'i paraqitet detyrimisht parlamentit, ku në të gjitha dëgjesat që janë bërë në qytetarët dhe ku cilësohet fare qartë dhe fare mirë konkluzioni i përgjithshëm, ku thuhet: qëndrimi dominues dhe i përsëritur kundër propozimit për bashkinë me Bashkinë Maliq me Bashkinë e Korçës. Pra, të gjitha dëgjesat që janë bërë nëpërmjet qytetarëve kanë qenë kundër këtij bashkimi. Gjithashtu, ne na ka erdhur edhe një draft, një projektvendim, për të parë mos-dakordësinë, më falni, apo jo dakordësinë me Bashkimin e Korçës, ku komisioni, duke hequr pikën 3 dhe 4 të këtij

projektvendimi, gjithashtu duke hequr edhe një fjalë ku thuhet "të konstatojë se mendimi i popullsisë se njësimet e prekura nga organizimi, i përfshirë i popullsisë i territorit aktual të Bashkisë Maliq" ishte fjala e Bashkisë Korçë. Aktualisht, komisioni, unanim, me 5 veta, ku marrin pjesë Pranvera Begolli kryetare, Petrit Kupe anëtar, Yllsoni Brahimlari nënkryetare, Egla Balliu sekretare, edhe Kristina Malherlli anëtare, vendosi që është kundër bashkimit të Bashkisë Maliq me Korçën. Ky është vendimi që ka marrë në bazë të këtij projektvendimi komisioni. Gjithashtu, është edhe vendimi që kemi këtu të paraqitur, kështu që, në bazë të dokumentacionit që ne na është përcjellë, duke patur përkrah edhe dëgjesat publike që janë bërë në territorin e bashkisë, komisioni ka dalë me një mendim, për të kaluar në vendim, që aktualisht ne jemi kundër bashkimit të Bashkisë Maliq me Bashkinë e Korçës. Ju faleminderit. Nëse ka dikush për të plotësuar, mund të flasë.

Ornildi Demollari:Faleminderit. Ka ndonjë koment tjetër rreth kësaj? Po.

Yllson Ibrahimllari:Në emër të grupit të këshilltarëve të opozitës, falënderoj komisionin, por falënderimi i vjen së pari dëgjesave publike, ku i gjithë komuniteti e shprehur në tërësinë e vet në procesverbalet e mbajtura që është kundra propozimit të ndarjes së re territoriale, që nënkupton bashkimin e Bashkisë Maliq me Bashkinë Korçë, me argumentat e largimit nga shërbimet, problemet e tjera të infrastrukturës, problematikës së njëjetese. Ne jemi këtu për të zhvilluar kapacitetet ekonomike të Bashkisë Maliq dhe jo për të bërë një ndarje territoriale e cila do të ishte një bashkim jo rezultativ. Ftoj kryetaren e këshillit, kryetaren e komisionit të rregullores, ligjit e të tjerë, të lexojë vendimin pavarësisht dy pikave të hequra. Ky vendim ka ardhur i propozuar nga shumica e anëtarëve të Këshillit Bashkiak. Ne kishim propozuar një vendim me 1/3 të anëtarëve, të cilin, për arsye të kompromiseve dhe rezultateve dhe thellimit në atë, ju kërkuat një afat kohor për dëgjesat, për sqarimet. Tashmë jemi të sqaruar. Këshilli Bashkiak, komisioni ka dalë me për t'i thënë "jo" bashkimit fiktiv të Bashkisë Maliq me Bashkinë Korçë. Ju faleminderit.

Ornildi Demollari:Faleminderit. Ka ndonjë koment tjetër ose ndonjë pyetje? Po, urdhëro.

Faslli Zholi:Përshëndetje kryetar i këshillit. Përshëndetje kolegë këshilltarë. Përshëndetje deputete zonja Ledina. Përshëndetje pjesëmarrës. Më vjen mirë që komisioni i mandateve dhe ligjeve shprehet për mos-bashkimin e Bashkisë Maliqit me Korçën, sepse këtë nuk e bëjmë neve për të mirën tonë si këshilltarë, apo kaq themi në sallë, por humbasim të gjitha shërbimet që kërkojnë qytetarët e Bashkisë Maliqit në çdo fshat, apo edhe si qytet. Dhe desha të shtoja një diçka që më mirë vonë i thënë sesa kurrë. Neve i kemi bërë dëgjesat ashtu siç u përmend në material, me qytetarët, ku qytetarët, pa dallime partiake, ato që ne i kemi parë dhe i kemi regjistruar, i kemi mbajtur shënime, qytetarët janë mos-bashkimit të Bashkisë Maliqit me Korçën. Kjo është një risi, edhe nuk është në dëshirë, sepse do njëri apo s'do tjetri, se po të jetë për mua, le të bashkohet edhe me Elbasanin, por nuk është kështu. Realiteti është ndryshe, se qytetarët kërkojnë më shumë dhe ata na kanë zgjedhur neve këtu, dhe ne do t'i dëgjojmë ata, dhe unë nuk jam për atë që dëgjoja nga kushdo që me një të rënë të lapsit ta çojë në Bashkinë atje,

dhe pa pyetur pastaj se çfarë mund të sjellë pasojat mbrapa. Duke u falënderuar për këtë, dhe mendoj që jemi në rrugën e duhur. Faleminderit të gjithëve.

Lulëzim Hoxhaj: Përshëndetje të gjithëve. Unë doja të bëja vetëm një koment. U deklarua edhe nga fjala e zonjës Vera që në dëgjesat e bëra, pothuajse mbi 95%, të gjithë qytetarët që kanë marrë pjesë në këto dëgjesa kanë dhënë mendimin që të mos bashkohet Bashkia e Maliqit me Bashkinë e Korçës. Tani, ne si këshilltarë jemi përfaqësues të këtij populli, të këtij populli që ka thënë këtë fjalë, fjalën e dha populli, ne jemi përfaqësuesit e këtij populli, se ata na kanë zgjedhur, na kanë sjellë këtu në këtë sallë, ne na mbetet tani vetëm për të certifikuar mendimin e tyre. Unë mendoj që nuk ka më komente për këtë punë. Me një fjalë, faleminderit.

Petrit Kupe: Përshëndetje të gjithëve. Këshilli vendosi që të ruajë statusin e Bashkisë Maliqit, pra duke mos pranuar bashkimin me Bashkinë e Korçës, por indirekt këshilli shprehet dhe kundra projektit të 100 bashkive që është propozuar nga opozita. Kështu që ne si këshill jemi. .. s'ka kohë ndoshta kur të vijë, por ne jemi kundra edhe këtij projekti. Faleminderit.

Ornildi Demollari:Ka ndonjë koment tjetër rreth kësaj? E kalojmë në votim atëherë pikën 4, pra propozimin për bashkimin me Bashkinë e Korçës.

Yllson Ibrahimllari:Për procedurë. Ne kemi një... na ka sjellë Kuvendi i Shqipërisë një projekt reformë, draft mbi të cilin flasim. Opozita nuk ka sjellë në Këshillin Bashkiak në adresa zyrtare, është vetëm një publike. Ne nuk mund të shprehemi për diçka që kanë sjellë publike. Edhe unë kam rezervat e mia për 100.

Pranevera Begolli: Kryetar, mendimi i komisionit të hidhet në votim. Kush është pro mendimit të komisionit për kundër bashkimin me. ..

Ornildi Demollari:Po, pra, hedhim projektvendimin. Të lutem. Ju lutem, ju lutem. Ju lutem. Ju lutem, ju lutem. Nënkryetarin e keni këtu. Ta kalojmë në votim pikën 4. Pikën 4 ta kalojmë në votim: propozimin për Bashkinë e Maliqit me Bashkinë... Bashkinë e Maliqit me Bashkinë Korçë. Kush është dakord për bashkimin? Një vote(Idlir Limllari). Kush është kundër për bashkimin?Kundër. Atëherë, me 17 vota kundër. Abstenim ka? Nuk ka. Me 17 vota kundër dhe 1 pro, vendimi nuk miratohet. Shumë faleminderit. Shprehim mosdakordësinë. Kalojmë tek pika 5 e rendit të ditës.

Pranevera Begolli: Kryetar, kemi 22 veta. Dakord, 21 me 21 kundër me 1 pro. 21 kundër me 1 pro. Jemi 22 këshilltarë në sallë. Një është kundër, 22 janë kundër bashkimit me Korçën. Një është pro.

Ornildi Demollari:Po, pra, 21 këshilltarë janë kundër, 1 është pro(Idlir Limlalri) . Kalojmë tek pika 5 e rendit të ditës: projektvendim për miratimin e ndihmës ekonomike deri në masën 6%. Ju lutem, kush... ju lutem, kush nuk ka interes më, mund të largohet. Faleminderit. Kalojmë tek pika

5 e rendit të ditës: projektvendim për miratimin e ndihmës ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin gusht 2026. Jemi tek pika 5 e rendit të ditës: projektvendim për miratimin e ndihmës ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin gusht 2026. Komisioni? Komisioni për ndihmën ekonomike.Këshiltari Yllson Ibrahimllari largohet nga mbledhja, në sallë mbeten 20 Këshilltarë.

Faslli Zholi: Tashti. Për sa i përket pikës 5, për ndihmat ekonomike, ne si komision u mblodhëm, i diskutuam, i pamë, dhe ftoj këshilltarët ta votojnë pro ndihmën ekonomike. Faleminderit.

Ornildi Demollari:Ka ndonjë pyetje ose koment tek pika 5? E kalojmë në votim atëherë pikën 5. Kush është dakord? 21 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim, nuk ka. Me 21 vota pro miratohet. Kalojmë tek pika 6 e rendit të ditës: projektvendim për dhënien e ndihmës financiare për familjet në nevojë. Pika 6, komisioni.

Faslli Zholi: Tashi, edhe këtë familje ne e pamë dhe dokumentat, e konsultuam në komision. Mendojmë që t'i jepet ndihma ekonomike sipas dokumentacionit që kishte paraqitur.

Ornildi Demollari:Ka ndonjë pyetje te kjo? Ndonjë koment tek pika 6? E kalojmë në votim. Kush është dakord? 21 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim nuk ka. Miratohet pika 6. Faleminderit. Kalojmë tek pika 7 e rendit të ditës: projektvendim për shqyrtimin e kërkesës për rishikimin e strukturës dhe bonitetit të tokës për pasuri të pronësi të shoqërisë "Toptani" CSE.

Pranevera Begolli: Do të kemi përfaqësues nga administrata, kryetar.

Ornildi Demollari:Ja ku është drejtori i agjencisë. Provoje dhe atë. Provoje njëherë ti.

Përgjegjës i Sektorit të Bujëqsisë;z.Aurel Zenunllari: Atëherë, përshëndetje. Një shoqëri private u bazua në ligjin 121, në vendimin numër 121, datë 17. 02. 2011, për detyrat dhe funksionet e zyrave të bujqësisë, zyrave të mbrojtjes së tokës në njësitë vendore dhe në qarqe. Ka paraqitur një subjekt privat kërkesë për rishikimin e bonitetit të parcelave të cilat i ka në pronësi, me certifikatë pronësie, në fshatin Gurabardhë, njësia administrative Pajan, e cila është pjesë e hapit të parë të kësaj procedure. Menjëherë pas vendimit të këshillit, dokumentacioni i përcillet këshillit të qarkut, i cili jo detyrimisht miraton atë kërkesë të subjektit apo të bashkisë, por në rast se miratohet, në bazë të dokumentacionit, i kalon strukturës përkatëse në ministri për marrjen e analizave, mostrave, për rishikimin e bonitetit të strukturës së këtyre dy parcelave. Për çdo pyetje?

Ornildi Demollari:Kemi ndonjë pyetje?

Lulëzim Hoxhaj: Edhe ne si komision e shqyrtuam këtë material. Biem dakord, me fjalë, që kjo të miratohet dhe i kërkojmë edhe këshillit, me fjalë, që ta mbështetin për ta kaluar, për ta miratuar.

Ornildi Demollari:Faleminderit. Ka ndonjë pyetje tjetër?

Fevri Sherifi: Dua të di më ku është kjo parcelë. Në çfarë vendi bie në Gurëbardhë?

Ornildi Demollari:Po, Reli, ku ndodhet kjo? Ose njëra është apo disa?

Përgjegjës i Sektorit të Bujëqsisë;z.Aurel Zenunllari: Janë dy parcela, njëra pas tjetrës, me numra pasurie të ndryshme, me certifikatë pronësie, me lokacionin, domethënë në territorin e fshatit Gurabardhë, njësia po janë, dhe ngjitur me fshatin Bregas, domethënë në kufi, ku ndahet Vreshtasi me Pojanin, rrezë malit, po, anës rrugës. Janë me certifikata pronësie në pronësinë e një subjekti privat.

Fevri Sherifi: Kjo ka qenë vresht, e gjitha, e gjitha vreshtet deri në Shëngjinjtë, që bien mbi rrugën, mbi rrugën kryesore. Kjo do të jetë patjetër për energjinë elektrike. Për atë duhet të jetë.

Ornildi Demollari:Bëhet... bëhet një rikategorizim i tokës.

Faslli Zholi: Jo, kërkojnë që t'i japim neve rrugën, pastaj të bëhet kategorizimi.

Përgjegjës i Sektorit të Bujëqsisë;z.Aurel Zenunllari: Ashtu siç e shpjegova, detyrat dhe funksionet janë përcaktuar në ligjin 121, datë 17. 11. 2011, të cilat përcaktojnë qartë se çfarë detyra ka njësia vendore, çfarë detyra ka Drejtoria e Administrimit të Mbrojtjes së Tokës në qark, dhe më pas ministria me strukturat e saj në varësi.

Ornildi Demollari:Ne shprehim vetëm një dakordësi në parim.

Përgjegjës i Sektorit të Bujëqsisë;z.Aurel Zenunllari: Po, quhet nisja e procesit. Asnjëherë, në asnjë rast, bashkia nuk shprehet për çfarë boniteti ka kjo tokë dhe nuk e përcakton bashkia atë.

Ornildi Demollari:Jemi të qartë? E kalojmë në votim atëherë. Kush është dakord? 20 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim 1 votë. Me 20 vota pro, një abstenim. 20 pro, një abstenim. Miratohet. Faleminderit. Kalojmë tek pika 8 e rendit të ditës: projektvendim për miratimin e dhënies në përdorim të përkohshëm të disa pronave të paluajtshme publike në pronësi, përdorim, të Bashkisë Maliq, subjektit "Fasnet Albania" sh. p. k., me qëllim zhvillimin e projektit për ndërtimin e rrjetit inxhinierik telefonik me fibër optike. Komisioni?

Petrit Kupe: Po, ne e pamë këtë projektvendim dhe në parim jemi dakord që t'i jepet mundësia kësaj kompanie për të investuar nga rrjeti ajror në atë kabllor, por jemi si të paqartë, ose një listë

e madhe pronash të papërcaktuara sipërfaqet që do të përdoren nga kjo. Nuk e kemi të qartë, se kjo përfshin tërë rrugët, sistemi rrugor të Bashkisë Maliqit, dhe nuk e kuptojmë sa do zgjatë kjo dhënie në përdorim. Duhet të ketë një afat, sepse në gjatëpunime të zgjatura mund të krijohen probleme në sistemin e qarkullimit rrugor. Gjithashtu, jemi të paqartë, duhet të na e shpjegojnë përfaqësuesit e këtij projektvendimi çfarë të ardhurash realizon në favor të Bashkisë Maliqit gjatë këtij realizimi të këtij projekti që ka të bëjë me rrjetin kabllor. Faleminderit.

Pranvera Begolli: Po vijnë përfaqësuesi.

Ornildi Demollari:Hajde këtu, hajde këtu përpara. Hajde një çik këtu përpara, ku është ai mikrofoni. Hajde, s'ka gjë. Ulu aty këtu. Do të jesh... do flasë komisioni, pastaj ne.

Ornildi Demollari:Idlir, ke fjalën.

Idlir Limlllari: Tani do ndërtohet një linjë për të shtrirë kabllin, mirëpo problemi qëndron në marrjen e lejes. Duhet të shënohen të gjitha pronat atje. Prandaj janë aq listë e gjatë e pronave. Besoj që në leja e ndërtimit janë dhe afatet. Nuk është se kjo firma i ka marrë këto pronat tona me qira. Thjesht do kalojë linjën e telefonit atje. Kaq.

Ornildi Demollari:Faleminderit. Zoti kryetar, mirë se erdhe. Jemi tek pika 7. Te 8-a, më fal, për dhënien në përdorim të përkohshëm të disa pasurive të paluajtshme. Dhe tani duam një shpjegim se çfarë është kjo.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Përshëndetje të gjithëve. Në fakt, sapo ne kemi filluar një plan veprimi në lidhje me heqjen e të gjithë rrjeteve kabllore që janë ajrore. Të gjithë jemi të vetëdijshëm që rrjeti i merimangave nëpër qytete, veçanërisht, por edhe nëpër fshatra, në rrugët urbane, në rrugë rurale, është bërë një... edhe nga ana vizive, ka kabllo të cilët janë jashtë funksioni, shumica e tyre jashtë funksionit edhe për efekt të ndryshimit të teknologjisë. Dhe qeveria, AKEP-i, kanë vendosur një ndërhyrje në plan të gjerë për të gjithë Shqipërinë. Midis tyre dhe ne kemi filluar një plan veprimi, kemi bërë një rregullore e cilën ia kemi çuar dhe këshillit të bashkisë për ta miratuar për efekt të kësaj qëllimi. Dhe në këtë pikë, të gjithë operatorët të telefonisë apo të rrjeteve të internetit, me një urdhër tim, janë ndaluar për vendosje kabllosh të rinj në territor. Edhe për lidhje familjare, ata duhet të marrin një autorizim që, se luajnë ndonjëherë me këtë, jo e kemi lidhje, jo e kemi rrjet të ri, e të tjera, e të tjera. Kemi filluar heqjen e një sasie të madhe kabllosh në qytet, veçanërisht apo në zona urbane ku është më shumë. Dhe në këtë aspekt, në zbatim edhe të këtyre akteve ligjore në fuqi, të gjitha kompanitë e telefonisë, të internetit, të rrjeteve kabllore kanë filluar të aplikojnë në sistem për të marrë leje, që të gjithë rrjetet gradualisht, se njëherësh nuk kalojnë të gjitha, në bashkëpunim edhe me bashkinë, atje ku ne investojmë, i themi shtrini rrjetet, apo atje ku ne vendosim rrjetet tona, kundrejt tarifave që ata duhet të paguajnë. Dhe shumë e rëndësishme që ata tani kanë filluar të lëvizin që të marrin projekte, të ligjërohen dhe të hyjnë në sistem për leje ndërtimi. Por që të marrin këtë qëllim, ky vendimmarrje është hapi i parë, i cili jep një klauzolë që ata të hyjnë në

sistem. Nuk është leje, nuk është që ne. .. vendimmarrja juaj u jep që ata të hyjnë, por u jep mundësinë që të hyjnë në sistem për të aplikuar për leje, dhe urbanistika pastaj zbaton gjithë aktet ligjore në fuqi, që ata me një program, me një plan, me një rrjet shpërndarës, me kosto me të tjera, të marrin leje për të operuar. Edhe për kthimin e të gjithë dëmeve që mund të ndodhin në territor, zona të caktuara, në gjendjen e mëparshme. Kaq, shkurtimisht. Nuk ka se kjo vendimmarrje e këshillit po u jep atyre prona apo të tjera, e të tjera.

Ornildi Demollari:Faleminderit. Ka ndonjë pyetje tjetër? Për? Për çfarë? S'kemi arritur atje. S'kemi arritur. Atëherë kemi pyetje.E kalojmë në votim pikën 8, ju lutem. Kush është dakord?

Përfaqësues i subjektit Masa Group:Të flas pak unë?

Ornildi Demollari:Po.

Përfaqësues i subjektit Masa Group: Po. Sa i përket për linjat nëntokësore të Fasnetit. Vetëm ai e ka të drejtën që të operojë?Kur? Jo, jo. Kur do ta bëjë linjën e tij? Sepse ne si subjekt nuk kemi pyetur për këtë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Çdo subjekt është i lirë të aplikojë. Të lirini dhe ju e çdo subjekt për të bërë punë. Jo, jo. Ai ka bërë kërkesën e tij. Problematikat e subjekteve nuk mund të jenë pjesë e mbledhjes së këshillit. Subjekti në fjalë, por çdo subjekt ka të drejtë të plotësojë dokumentacionin. Edhe subjekti i cili po merr sot një "ok" në parim nga këshilli, edhe ai duhet të plotësojë A nga A-ja në Z, të gjithë detyrimet ligjore të dhënies së leje ndërtimit. Por nuk është kaq e thjeshtë, si për atë, si për ju, ose si për këdo tjetër. Gjërat janë shumë strikte, se nuk mund të shkatërrojmë ne një qytet, një zonë, një bashki të tërë, vër kabllo andej, vër kabllo andej, edhe një papërgjegjshmëri maksimale, po them nga subjektet tuaja, për mënyrën se si i shtrini kabllot, si i vendosni, nga ikni e çfarë bëni. Po mos e hapim këtë pikë. Kjo është e thjeshtë. Sa i shkon njëherë për të shtrini të drejtës për linjat e tij, apo jo?Ai do t'i investojë për veten e tij, jo për ju. Nuk investon për ju. Tubacionet që ka bashkia kanë të drejtë t'i kërkojnë të gjithë brenda rregullave në fuqi. Tubacionet që biznesi privat i shtron vetë, i ka të tijat.

Petrit Kupe: Po në qoftë se duan disa kompani të shtrin rrjet nëntokësor, si do bëhet?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Të gjitha shikohen nga duke plotësuar dokumentacionin që nga AKEP-i që është në Tiranë, e deri në zyrën e urbanistikës në qytet, në bashki, e cila merr gjithë dokumentacionin. Këto subjekte të cilat reagojnë, marrin nga një leje edhe fillojnë të shtrinë kabllo sikur janë... çfarë të them unë, që mos e...

Petrit Kupe:E kemi fjalën, e kemi fjalën. Çdo subjekt mund të kërkojë, vendosë...

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Çdo subjekt duhet të ligjërohet dhe të jetë brenda rregullave për çdo gjë. Duhet të pastrojë linjat ekzistuese dhe të fillojë nga para. Këtë do të bëjë

edhe ajo subjekt që ka aplikuar. Nuk mund të shtrijë rrjet të ri pa liruar të gjithë rrjetin e merimangave në qytet dhe në çdo fshat.

Petrit Kupe: Jo, jo, nuk u kuptuat. Në qoftë se kërkojnë tre kompani të shtrinë, në rrugët tona do bëhen treçarje?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Jo treçarje, jo. Do jepet leje dhe do të shikohet. Ajo ka një plan veprimi i cili nuk shtrihet në një muaj, në një vit. Shtrihet ndër vite.Jo, pra nuk jepet leje. Nuk jepet. Nuk jepet leje. Nuk jepet leje. Në çdo rast, për shembull, sapo hapet... në qoftë se unë... ne bashkia sot po shtron 15 rrugë në asfalt, atëherë u thotë subjekteve private që kanë... janë të licencuar, që urdhëro tani që vëre tubën tënde këtu pa na dëmtuar ne asfaltin dhe e ke tubacionin. Në qoftë se në atë moment nuk ka subjekt tjetër, ne nuk mund t'i marrim me zor. Dhe kjo do e vështirësojë. Ndaj dhe ne e kemi hapur këtë, që ata duhet të fillojnë të kërkojnë dhe të aplikojnë me projekte tek zyra e urbanistikës që ne të bëjmë një plan veprimi për të gjithë bashkinë. Po kjo s'mund të jetë pa limit.

Plator Çollaku: Një gjë tjetër është sa dëmtohet infrastruktura nga kjo. Se normal që në qoftë se hapet kanal, do dëmtohet. Dhe tjetër, duhet të ketë edhe disa gjëra që këto subjekte duhet t'i riparojnë këto dëme. Se nuk mund të jetë gjithmonë...

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:E citova, por e shpjegova që ato duhet ta kthejnë çdo gjë në gjendjen e mëparshme.

Plator Çollaku: Jo vijën, se herë pas here çfarë bëjnë? Hapin një kanal e e mbushin atë vijën me beton.

Ornildi Demollari:Idliri.Po.

Petrit Kupe: Kryetar, më fal. Në këto rrugët e reja, nuk është më mirë bashkia të shtrojë një tubo dhe pastaj subjekteve t'i kërkojë tarifën nesër? Se subjekti sot është, nesër nuk është. Faleminderit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Të gjitha rrugët interurbane, të themi që ne bëjmë, ne i kemi shtruar edhe me tubacion. Rruga Maliq-Libonik, rruga nga Liboniku në Drithas, rrugë të cilët kanë edhe një shtrirje shumë të gjerë ku ka edhe popullata më të madhe. Kemi. Kjo janë çudi e madhe. Ne u themi: "Ejani të operoni, këta vazhdojnë, kanë vazhduar akoma të tyren sa është shtuar mësuar." E kanë çudi të madhe se duhet të paguajnë lekë atje pastaj. Duhet të paguajnë tarifën për. .. nuk është e njëjta gjë, por duhet ta paguajnë tani. Nuk ecën ndryshe. Pa marrë subjekte të veçanta me emër, se nuk dua t'i bëj reklamë ose antireklamë as njerëz, po them janë nga subjektet të cilat krijojnë më shumë probleme në territor.

Ornildi Demollari:E kalojmë në votim. Kush është dakord? 20 vota pro.

Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka. Me 20 vota pro, miratohet. Faleminderit. Kalojmë tek pika 9 e rendit të ditës, që është projektvendim për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit Bashkiak me numër 2, datë 8. 01. 2026, për miratimin e nivelit të punonjësve, nivelin e pagave të administratës së Bashkisë Maliq dhe strukturave të tjera për vitin 2026, i ndryshuar. Kush e do fjalën? Ka ndonjë pyetje?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Janë vetëm dy rregullime për pjesën page. Nuk ka ndonjë lëvizje, as në ndryshime, as në...

Petrit Kupe: Ndryshime pagash në pjesën e parë, kryesisht për rritje pagës nga ajo ekzistuese, dhe shtesa në strukturë për tre pozicione sekretarë nëpër shkollat, nëpër shkollat që është përcaktuar aty. Ne jemi dakord. Ndoshta është fare e domosdoshme të ketë nga një sekretar aty.

Ornildi Demollari:Ok. Ka ndonjë pyetje tjetër? E kalojmë në votim. Kush është dakord? 20 vota pro.Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka. Me 20 vota pro, miratohet dhe pika 9. Kalojmë tek pika 10, informacion për raportin e dytë të monitorimit të buxhetit për katërmujorin e dytë të vitit 2026. Komisioni i financës? Kryetar, pra.

Petrit Kupe:Është një informacion periodik që jepet në çdo katërmujor, ku pasqyrohen të ardhurat dhe shpenzimet për periudhën që flitet. Bëhet fjalë që disa tregues janë të realizuara, disa jo, sepse realizohen periudha e mëparshme. Ne jemi dakord që të miratohet ky raport.

Ornildi Demollari:Është informacion.Faleminderit. Atëherë jemi tek pika e fundit, diskutime të tjera.Po, zonjë, tani është radha juaj. Çfarë kishit?

Qytetare: Kam marrë për pallatin. Kam marrë për pallatin në Libonik, ku? Në Libonik.Në Drithas. Po. U bënë çati me radhë. Unë nuk kam qenë këtu. Tani kam ardhur. Dhe pallati tonë u bë la gjysmë pa bërë. Një. Pallati është katastrofë. Toni është katastrofë. Po bie. Kanë vënë këto ulluqet, i kanë vënë sipër banjës time të pallatit tjetër që është ngjitur. Pse? Se nuk kanë hapësirë që të hyjnë të vënë ulluqet deri poshtë. Lirim. Anën e mbanë pallatit, edhe çati duan. Një. Dhe kanë ardhur këta ujësjellësit, kanë bërë ujësjellësin poshtë, na e kanë çarë asfaltin dhe e kanë lënë pa bërë. Kudo në botë ka defekte, hapen po dhe mbyllen me asfalt. Nuk lihen ashtu. Një shi të bjeri, unë kam video, del uji përsipër mbytesh. Kemi pusetën e ujërave të zeza, na del mbytet pallati. Mbytet tani, po në dimër. Po doni t'jua jap edhe ta shikoni videon që kanë bërë me ujë i zi, ujërat e zeza, është turp. Kalojnë mbi ujërat e zeza, të hyjnë në pallat. Kjo nuk është parë asgjëkundi.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Tani mund të shpjegoj diçka. Duhet të kuptoni që pallatin. Jo, s'ka rëndësi. Po jo, ato firma, ata banorë duhet ta bëjnë vetë pallatin. Dëgjo gjënë në fund. Pallatet janë banesa kolektive të banorëve. Që ta kuptojnë se duket ndonjëherë sikur na i

vini ne detyrim, sikur e kemi ne detyrë për të rehabilituar gjithë pallatet. Jo, nuk është kështu. Ne vërtetë kemi ndërhyrë si institucion, si bashki, në shumë pallate dhe shumë mirë kemi bërë, por mundësitë financiare nuk janë që ne të bëjmë. Kemi ndërruar, ndaj bëjmë dhe hap pas hapi, se ne nuk kishim ndonjë gjë me një pjesë të banorëve aty. Kur bëmë tre çati, edhe mbeti një copë, do të thotë që aq ishin fondet në atë moment.

Qytetare: Gjysma është e pabërë. Atë gjysmën e lini që e kanë bërë ata e bëjnë, se unë e bëj. Po s'e bën komshiu që kam ngjitur.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Nuk e kam vetëm me ju, të lutem. E kam me të gjithë banorët që jetojnë nëpër banesa kolektive nëpër pallate. Ata urgjentisht duhet të bëhen me administratorë të pallateve bashkë me ne dhe duhet të kontribuojnë me disa tarifa për ta mirëmbajtur pallatin. Se nuk arrihet, nuk arrijmë dot dhe ne t'i bëjmë gjërat. Dhe në qoftë se ka patur dhe edhe Maliq në qytet, bashkëpunime të banorëve që kanë mbledhur x fonde, i ka mbështetur këshilli i bashkisë edhe me x fonde dhe e kanë bërë. Por s'mund të jetë sikur na i lini ne edhe sikur ne e kemi detyrë, ne duhet të vazhdojmë dhe juve të mos bëni asgjë.Por nuk është vetëm pallati juaj. Më dëgjo, zonjë kryetar. Nuk është vetëm pallati juaj. Edhe në Maliq, edhe në Libonik. Por secili shikon vetëm pallatin e tij. Unë le të jetë kjo çfarë po citoj në këtë moment, edhe një apel për të gjithë komunitetet që jetojnë nëpër banesa kolektive që duhet të bëhen bashkë për mirëmbajtjen dhe për rehabilitimin e tyre. Patjetër bashkia ndihmon, por po pritet vetëm nga bashkia, do kohë që të bëhen të gjitha. Do kohë, se pastaj duket sikur. Kurse për shqetësimet e tjera, për atë dëmtimin e asfaltit, po aty ke të drejtë, duhet ta verifikojmë ne urgjentisht për t'i dhënë zgjidhje.

Qytetare: Edhe lirimin e atij pallatit, se neve nuk po hyjmë dot të vejmë në ulluqet. Ai nuk e vura ulluqun poshtë, ta kanë vënë ty sipër. Po pse?

Faslli Zholi: Zonja, zonja e bën mirë. Falenderoj që sepse mua më kishin zënë dhe disa qytetarë që banojnë atje. Faktikisht është realiteti atë video që nxjerr ajo që ai pallat ka nevojë për dorë. Dhe jam dakord me fjalën tuaj që të ketë një administrator, se çdo gjë nuk bëhet kudo, bëhet edhe me një studim. Dhe ai administratori mbledh 5 lekë dhe 5 i vë bashkia që ajo të zgjidhet. Unë duhet të shtoj këtë që ato e tha kryetari që gropat e tëra, sepse unë kam edhe rrugën time atje që e kam ngritur disa herë, po mbaron mandati dhe nuk është bërë as asfalt, asgjë. Është prishur nga ujësjellësi. E di dhe kryetari e di këshilli. Po duhet parë me përparësi dhe mundësisht, kryetar, se ai. Të bëni vetëm çatinë të paktën, sepse po s'pjekoj lart, pastaj poshtë edhe zgjidhen nga këmbët. Po problemi është madh ose aty kur vjen ujit, po që se e di mirë zonën, vënë dru. Është u dras që hiqen njerëzit se nuk futen dot. Mua më kanë ardhur disa zonja që nuk i njoh dhe zonjën nuk e njoh. Po e them me sinqeritet. Po më kanë ardhur që ngriheni këtë problem. Shikoheni me përparësi. Të parët i ke një të drejtë, se s'je vetëm ti. Atje janë shumë njerëz edhe të riparohen ato. Faleminderit.

Petrit Kupe: Drejt me thënë ky propozimi që bëhet që të mblidhet përfaqësuesja e pallatit, kujdestari i pallatit, ka qenë një propozim i errshëm dhe duhet ta pranojmë që nuk ka funksionuar. Duke parë këtë mosfunksionim, vitet e fundit nga ana e bashkisë është ndërhyrë mjaft për sistemin kapot të pallateve, por gjithashtu dhe për rehabilitimin e çative, me fonde nga buxheti apo nga fondet nga bashkia. Aty në Drithas është bërë një punë e mirë. Gati 60% e pallateve janë rikualifikuar, por ka ende pallate të cilat kanë nevojë për këto. Edhe njerëzit kanë shpresë, meqënëse u fillua kështu, të vazhdojë. Nuk e dimë për këtë vit do ketë apo s'do ketë fonde për këto dy forma të investimit. Mjaft çati janë të pabëra, mjaft pallate janë të paveshura me sisteme kapot. Nuk besoj se ka në Maliq kaq shumë, por në Drithas, në Drithas janë gati 40% e pallateve të pa. Edhe kjo ka krijuar le që s'ka funksionuar më përpara ky bashkimi, nuk funksionon në pallatet tona. Për shumë arsye mos i rënditim, por mendoj se duhet të vazhdojë. Kemi shpresë këtë vit, ndoshta vitin e ardhshëm, nuk e dimë si do bëhet. Po njerëzit presin që në këtë pjesë të pa të pazhvilluar të vazhdojë. Kaq kisha.

Ornildi Demollari:Po.

Lulëzim Hoxhaj: Më fal kryetar. Tani, me thënë të drejtën, ca gjëra duhen thënë, duhen thënë shqetë. Mos flasim tani që komuniteti të vijë në ndihmë të komunitetit ta bëjmë me këtë andej. Ajo është një pronë private, siç është një shtëpi, një banesë private. Edhe po të fillojmë kështu me fjalë, sa herë që i pikon çatia atij, t'i themi hajde ti si bashki dhe këtë andej. Mua nuk më duket e drejtë. Jo, nuk më duket, po kështu është. Kështu është. Vërtetë ka ndërhyrë bashkia dhe jo vetëm këtu, po pothuajse në të gjithë vendin, edhe në Tiranë dhe në vende të tjera, po ndërhyn, fillimisht ndërhyn në fasadat. Një pallat i vjetër është në fasadë, në rrugë, me një fjalë, atëherë bashkia ndërhyn për të krijuar një fasadë aty. Po nuk mund të ndërhyjë bashkia në të gjitha, në të gjitha rastet dhe në të gjitha problematikat që ka territori.

Ornildi Demollari:Faleminderit. Po, po.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ne kemi bërë një aplikim të ri pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit, se ata aplikojnë për të gjitha pallatet edhe godinat kolektive që ka territori i bashkisë, edhe më shumë kanë në Maliq, Libonik edhe në Drithas. Edhe shpresojmë që dhe këtë vit të jemi fitues me disa, por dua të them, në qoftë se ne kemi bërë një ndërhyrje goxha të madhe në Drithas, Maliqi nuk ka përfituar asnjë fasadë nga buxheti i shtetit. Pse? Se e kemi parë të arsyeshme që ai komunitet aty, ato banesa ishin në një gjendje më të keqe se në zonat e tjera. Jo se këtu s'duheshin. Me aplikimin e fundit i kemi çuar të gjitha godinat, por është një çudi shumë e madhe. Banorët, jo vetëm zonja, ka shumë të drejtë, e ngrejnë shqetësim se nuk është më banesë kolektive, po e gjithë barra i ngelet atyre që janë katet e sipërme, katet e pestë ta themi. Dhe nuk ka një ne jemi bërë disa herë, jemi munduar për të zgjedhur administratorët. Një pjesë e banorëve nuk janë se ka jashtë shtetit, një pjesë janë aty, nuk gjendet. Se po të ketë një bashkëpunim midis tyre dhe të mbledhin një sasi fondesh, të jenë të bindur që ata do të jenë të parët që këshilli do t'i do t'i mbështesë edhe me pjesën tjetër, pasi nuk paguajmë TVSH-në, nuk paguajmë fitimin e firmës, po banorët e bëjnë vetë. Ka ndodhur në një pallat në Maliq që e kemi

bërë rehabilitimin apo ndërtimin e një çatie të re me 20% të fondit, domethënë një kursim total i fondeve, por kjo nuk ndodh dhe gjen atë më kollaj duke na kërkuar ne llogari çdo ditë sikur ato janë banesa të bashkisë. Në fakt nuk është kështu. Janë banesa private të atij komuniteti që është atje. Megjithatë, pavarësisht kësaj, ne kemi sforcuar dhe kemi hedhur qindra milionë lekë çdo vit për këtë qëllim. Por kaq ka qenë mundësia. Bile kemi dalë ndonjëherë dhe jashtë mundësive tona për rehabilitim pallatesh. Jemi duke hedhur një fazë të dytë për, por po ju them që situata nuk është se nuk vë njeri, nuk zë njeri një gjë me dorë dhe kjo është vërtetë për të ardhur keq. Ka ikur tempi i punës që të zërë komuniteti i një pallati, një godinë kolektive të mblidhen dhe të japin një imazh pozitiv dhe të na kërkojnë dhe ne mbështetje pavarësisht patjetër që ne do i mbështesim të parët në nismën e tyre. Çfarë dua të them së fundmi? Unë mendoj që ne do të jemi përsëri fitues të një projekti, por ajo hyn, e përmendi pak Luli, jo vetëm për bukurinë që ka një pallat, sesa për efiçencën e energjisë me sistem kapot me felizol, për ngrohësi e të tjera, por ata nuk ndërhyjnë në çati. Ndaj dhe ky është një nonsens, një një problem i cili duhet zgjidhur midis nesh, edhe pse se kemi detyrë dhe komunitetit. Komuniteti duhet të jetë i pari i cili, kurse problemet e tjera që kanë të bëjnë me kanalet, patjetër që unë do t'i shikoj menjëherë për t'i zgjidhur sa më parë. Unë e di si raste të tjera të cilat fastliu ne i kemi futur në projekte, jemi sapo kemi filluar të zbatojmë rehabilitimin e 15 rrugëve në të gjithë territorin e bashkisë. Jemi duke bërë një projekt të dytë të fazës së tretë me fondet që janë kursyer nga prokurimet edhe për 10 rrugë të tjera. Po këto janë mundësitë tona. Domethënë, njëri kërkon rrugë, njëri kërkon pallat, njëri kërkon ujëra të zeza, njëri kërkon rrugë. Problemet janë të ndryshme. Nuk është ai pallati më i keq që ne kemi në territor. Nuk është. Jo, jo, nuk është ai. Po të them. Ai i keq është.

Qytetare:Dëgjo, atë pallat që ke bërë ti, ato fotot kanë sjellë të atij pallat se unë i kam parë të tëra në.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Unë kam çuar inxhinierët, grupin e inxhinierëve që kanë projektin për çdo pallat në. Po ç'ti ju dyshoni se unë e di më mirë se ju. Çdo situatë, çdo godinë.

Qytetare: Lirimi i këtyre pallateve.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Patjetër do të shikohet, do të shikohet menjëherë. Do të shikohet menjëherë. Nuk e di si rast, do ta shikojmë menjëherë.

Ornildi Demollari:Zonja e ngjitur. Urdhëro, çfarë kishe? Hape mikrofonin, hape atë, atë që ke aty.

Qytetare: Faleminderit.Përshëndetje kryetar, përshëndetje dhe juve. Atje të përshëndetje të gjithëve. Unë kam një problem me është kam bërë një kërkesë këtu në bashki dhe më është dhënë mundësia, më kanë rregulluar çatinë dhe ju jam shumë faleminderit. Jam mirënjohës. Tashi dua kam ardhur edhe për muret se jam plasaritur. Kryetari e din, e di mirë fare këtë punën. Tashi është bërë plasaritja e murit të futësh dorën. Ja kryetari e di atë se ka hyrë brenda. Tashi po deshi, ju lutem shumë të më ndihmoni dhe për muret se jam plasaritur shumë se s'kam nuk ku të

kërkoj ndihmë dy djem i kam të vdekur. Një që kam e kam keq edhe atë mendimin ekonomik keq. Tashi po do kryetari.

Ornildi Demollari:Mirë, faleminderit.

Faslli Zholi: Kam dhe një diçka tjetër meqë jam këtu. Kam marrë vesh nga mjaft tre katër ditë fshati Zbo që është pa energji, është djegur transmetori, vijnë vërdallë. Nuk e di a keni informacion edhe janë këta bashkë kështu se më zunë disa fshatarë të saj që dhe një kërkesë kam kryetar tek rruga e sheqerasit ka lënë vetëm një rrugë atje. Është kërkesë të cilën do ta kenë sjellë edhe këtu ata të sheqerasit. Është një rrugë në sheqeras vetëm ajo të ka ngelur. Kur t'ia gjesh mundësinë vëre në edhe njëherë që është e fundit ajo që e kërkojnë ata që.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ne kemi filluar bile sheqerasin ndoshta mund të jetë më i favorizuar me këto rrugë që.Bëjmë meqë më ngrite bëjmë një rrugë zgjatimin e rrugës në drejtim të thallave. Do të bëjmë një unazë rreth shkollës. Jo të plotë, por pjesën më të madhe e realizojmë tani. Është prokuruar dhe rrugën për të vajtur në varrezat e sheqerasit që është një pjesë shumë e keqe të cilën vëmë deri në ofiçinë e asfaltojmë dhe atë dhe japim goxha. Domethënë janë të futura dhe është prokuruar.

Ildir Limllari:Në Plasë nuk ka asnjë rrugë të bërë kryetar. Në plas 36 vjet asnjë rrugë nuk është e bërë. Asnjë rrugë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ore tani se mua më vjen ashtu të të them se ti vërtetë vërtetë rri në Korçë kështu mos rri me punë. Po rruga kryesore nuk është bërë në drejtim lart në drejtim të pompës së ujit. Po mos më thuaj asnjë o tani asnjë tani unë një po ta përmend 200 mjet e bëri fondi emergjenca apo jo bashkia?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:E ka bërë bashkia fondi emergjenca. Ore që ne ne bëjmë rrugën ore po megjithatë pavarësisht kësaj atëhere kemi kemi asfaltuar rrugën kryesore.

Ildir Limllari: Rruga kryesore ka qenë asfaltuar u prish dhe u bë në Plasë nuk e po tani po mos bëj se 36 vjet duhet të presësh 36 vjet të bëhet 200 m rrugë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Inxhinier jo jo ke të drejtë për atë unë s'po them se ne kemi bërë namin por në momentin në momentin kur thuhet s'është bërë asnjë rrugë unë janë bërë dy rrugë kush kë ka bërë fondin shqiptar zhvillimi e ka bërë bashkia me fondet e saj rrugë është bërë rrugë atëhere bashkia ka bërë asfaltimin e rrugës kryesore me trotuar nga krye deri në shkolla ajo ishte rrugë e b ore unë them e kemi asfaltuar ne tani më vjen keq tani o Ilir tani dhe kemi asfaltuar rrugën dhe kemi asfaltuar 200 m rrugë demokracia është këtu një tani është keq se i harrojnë njerëzit i kemi bërë rrjetin e ujësjellësit të ri ë kemi rehabilituar terenet sportive të shkollës kemi asfaltuar rrugën kryesore kemi asfaltuar një rrugë në drejtim të pompës që i del fund e krye rrugës kryepleqve çfarë i thoni ju apo s'quhet ajo ndaj paska po i kemi bërë ne mo e

ka miratuar këshilli këtu me projekt që kemi bërë pritat malore që mbyt plasa edhe kemi futur dhe këtë kemi bërë kanalin e betonit sipër e kemi bërë ne more tani ke bërë ore projekti i bashkisë ai thotë e ka bërë po s'bëra unë projekt për ta financuar si e bë ka fondi i emergjencave po më vjen keq kur e mohoni të paktën dhe atëhere për ta mbyllur se shumë mirë bën që jemi duke menduar për të vazhduar për të bërë një rrugë asfaltim në në qendër të fshatit ta quajmë atë që kalon nga aty ku ne kemi asfaltuar në drejtim të burimit është një që përfshin pjesën kryesore të të plasës një rrugë që për mua jep një një peshë të madhe e këtij fshati. Është e vërtetë që ndoshta duhet të kishim bërë më shumë. Kemi bërë rehabilitim, kemi bërë rehabilitimin e përroit matanë i cili ka marrë një investim që mbytse gjithë fshatin me prita apo dhe ajo emergjencave. Kemi çuar ne dhe kemi prokuruar ne. Ajo çfarë ne bëjmë apel mos mos hedhen me mbetje në përrua. Nejse se kryetar të merr ndonjë formulla e të folurit edhe.

Selami Muço: Kryetar po edhe për në Gjyrasë keni dhënë disa herë fjalën për të rregulluar një përmirësim disi asaj rrugës. Biles atij plakut të vjetër i keni dhënë fjalën direkt. Do ta bëjmë, do ta bëjmë edhe s'u bë gjë tashi.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Në Gjyrasë kemi ndërhyrë disa herë, por mua më vjen mirë ti si përfaqësues i atij fshati se s'ka shtëpi të tjera atje. Një shtëpi është.

Selami Muço: Po për atë bëhet fjalë më shumë për e kupton tani domethënë sa kilometra është ajo ne duhet të harxhojmë aq lekë dhe ndonjëherë edhe atje këto njerëz duhet ta bëjnë atje është thjesht prej ndërhyrje jo te te proje lart ndaj aq puna ti se ai plaku i vjetër domethënë sot për nesër është ai.

Ornildi Demollari:Mirë kjo ishte mbledhja e këshillit për sot. Faleminderit dhe tani ju lutem të mos largoheni pasi kemi diçka me asamblenë e përgjithshme të kombinatit të sheqerit.

Mbajtës Protokolli

SEKRETARI I KËSHILLIT

Gertjan GJIRITI

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ